



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1266 prot.

Tiranë, më 17.07.2019

**VENDIM**  
**Nr. 82, datë 17.07.2019**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 83, DATË 15.10.2018**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 83, datë 15.10.2018, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”,

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet informacionit me nr. 502 prot., datë 07.06.2018, nëpunësi \*\*\*\*\* , ka parashtruar përpara Komisionerit pretendimin se, procedura e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Autoritetit të Aviacionit Civil, nuk është zhvilluar në përputhje me përcaktimet e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, për këtë punonjësi.

Për të sqaruar rrethanat e rastit, Komisioneri, ka nisur fillimin e verifikimit të këtij informacioni. Në përfundim të hetimit administrativ procesi është përmbysur me Vendimin nr. 83, datë 15.10.2018, “Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”, në të cilin është vendosur:

“1. Të kërkojë nga Komisioni i Ristrukturimit për Autoritetin e Aviacionit Civil, ngritur me urdhrin nr. 12, datë 07.02.2018, të Departamentit të Administratës Publike, të shfuqizojë pjesërisht aktin nr. 958, datë 17.05.2018, konkretisht pikën 3 dhe 4, të dispozitivit të këtij akti, në të cilin propozohet shkëmbimi i pozicioneve të punës midis

*punonjësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

*2. Departamenti i Administratës Publike, duhet të shfuqizojë aktin nr. 2397/44 prot., datë 25.05.2018, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, si dhe aktin nr. 3937/2 prot., datë 25.05.2018, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”, ndaj nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin “Inspektor, në Sektorin e Çertifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.*

*3. Njësia përgjegjëse (DAP) dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, duhet të marrin masa për rikthimin e punonjësit \*\*\*\*\* në pozicionin “Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion, sipas aktit nr. 2397/36 prot., datë 10.04.2018, të Departamentit të Administratës Publike, “Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit.*

*4. Eprori direkt i nëpunësit (Drejtori i Drejtorisë së Sigurisë në Aviacion), në zbatim të nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të shfuqizojë vendimin nr. 1089/1 prot., datë 11.06.2018, në pjesën ku emërtohet pozicioni për të cilin bëhet konfirmimi, duke saktësuar se nëpunësi \*\*\*\*\* konfirmohet në pozicionin “Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion.*

*5. Më tej, njësia përgjegjëse, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në kreun VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të shfuqizojë pjesërisht aktin nr. 4353/2 prot., datë 21.06.2018, duke deklaruar statusin e punësimit për nëpunësin \*\*\*\*\* në pozicionin “Inspektor, në Sektorin e Certifikimit dhe Mbikëqyrjes së Personelit të Sigurisë”, në Drejtorinë e Sigurisë në Aviacion”.*

Në zbatim të vendimit paralajmërues nr. 83, datë 15.10.2018, të Komisionerit, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr. 7351/1 Prot., datë 14.11.2018, i ka kthyer përgjigje Komisionerit si më poshtë vijon:

*“... vlerësojmë se Vendimet nr. 2397/44 Prot., datë 25.05.2018 dhe Nr. 3397/2 Prot. datë 25.05.2018, të Departamentit të Administratës Publike, janë akte të nxjerra në zbatim të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”.*

Në vijim, me qëllim zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 83, datë 15.10.2018, Komisioneri me shkresën nr. 583 Prot., datë 06.05.2019, i ka kërkuar Autoritetit të Aviacionit Civil informacion në lidhje me masat e marra nga institucioni i mbikëqyrur për

zbatimin e këtij vendimi si dhe të gjithë praktikën shkresore që materializon zbatimin e vendimit paralajmërues të Komisionerit.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Autoriteti i Aviacionit Civil ka sjellë shkresën nr.914/1 Prot., datë 28.05.2019, në të cilën ka pasqyruar një analizë të rekrutimit, si dhe të pozicioneve të punës në shërbimin civil, në të cilat nëpunësi \*\*\*\*\* ka qenë i emëruar gjatë të gjithë periudhës.

Në analizë të praktikës shkresore të këtij rasti, vërej se:

Nga shqyrtimit i materialit shkresor i dërguar nga Autoriteti i Aviacionit Civil, rezulton se, struktura dhe organika e institucionit Autoriteti i Aviacionit Civil, në fund të vitit 2018, ka kaluar sërish në proces ristrukturimi me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2018, të Këshillit Drejtues, dhe Urdhrin nr. 2, datë 11.01.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Aviacionit Civil”*. Në përfundim të këtij procesi ristrukturimi, nëpunësi \*\*\*\*\* , konfirmohet sipas aktit të DAP me nr. 1216/34 Prot., datë 11.03.2019, *“Transferim për shkak të ristrukturimit të institucionit”*, në pozicionin *“Specialist i të Drejtave të Pasagjerëve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun”*, pozicion në të cilin ushtron detyrën aktualisht.

Në vijim, me e-mailin zyrtar të datës 21.03.2019, dërguar nga Specialistja e Burimeve Njerëzore të Autoritetit të Aviacionit Civil, nëpunësi \*\*\*\*\* është njohur me aktin e transferimit të tij nr.1216/34 Prot., datë 11.03.2019, nxjerrë nga njësia përgjegjëse DAP. Në përgjigje të këtij e-maili, nëpunësi i transferuar, me e-mailin e datës 25.03.2019, ka konfirmuar faktin e marrjes së tij.

Sa më lart, referuar pikës 20, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, të Këshillit të Ministrave, nëpunësi i transferuar, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja dijeni mbi aktin e transferimit, duhet të japë mendimin e tij me shkrim pranë njësisë përgjegjëse DAP. Në përmbushje të këtij detyrimi ligjor, referuar sa më lart, rezulton se, nëpunësi \*\*\*\*\* ka marrë dijeni mbi përmbajtjen e aktit të transferimit, sikurse është shprehur përmes e-mailit, por nëpunësi nuk kamaterializuar me shkrim mendimin për transferimin e tij.

Në këto rrethana, në kushtet kur provohet se, nëpunësi \*\*\*\*\* ka marrë dijeni për transferimin në pozicionin e ri të punës dhe nuk e ka ezauruar të drejtën e tij për të ankimuar këtë akt transferimi, brenda afatit ligjor të parashikuar prej 5 (pesë) ditësh, por vazhdon marrëdhënien e punësimit në pozicionin në të cilin është transferuar *“Specialist i të Drejtave të Pasagjerëve, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun”*, referuar nenit 80 të K.Civil, në të cilin thuhet se: *“Veprimet juridike mund të bëhen me shkresë, me gojë dhe me çdo shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit” (sipas Vendimit Nr.00-2013-763 i Vendimit (172), datë 05.03.2013, me “shprehjen “shfaqje tjetër e padyshimtë e vullnetit”, do të kuptojmë pikërisht, shfaqjen e vullnetit me veprime konkludente ose me heshtje”)*, gjykoj se me veprime konkludente nëpunësi e ka pranuar këtë pozicion.

Për sa u parashtrua më sipër, arrij në përfundimin se nga ana e institucionit Autoriteti i Aviacionit Civiljanë zbatuar rekomandimet e lëna në Vendimin Nr. 83, datë 15.10.2018, *“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”*, të Komisionerit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 83, datë 15.10.2019, *“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit, ndaj nëpunësit \*\*\*\*\*”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit të inspektuar Autoriteti i Aviacionit Civil, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 83, datë 15.10.2018.
3. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti i Aviacionit Civil, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi \*\*\*\*\*.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**